



REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUŠITRI

02 Nr. / Br 129/23

Nr. i fq. / Br. sh _____

Data: / Datum 08.02.2023

VUSHTRRI - VUŠITRI



KOMUNA VUSHTRRI

KRM "Uniteti" Sh.a Mitrovicë

ANEKS MARRËVESHJE MIREKUPTIMI

Ndërmjet:

- Komunës së Vushtrrisë përfaqësuar nga **z. Ferit Idrizi**- Kryetar i Komunës (këtu e tutje referuar si Komuna)

dhe

- KRM "Uniteti" Sh.a Mitrovicë, përfaqësuar nga **z. Gazmend Morina**, Kryeshef Ekzekutiv (këtu e tutje referuar si Uniteti)

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Aneks Marrëveshje është ndryshim plotësimi i Marrëveshjes 02Nr. 853/22, datë 08.07.2022, për Dhënien në Shfrytëzim të Aseteve Komunale KRM "Uniteti" Sh. A. në Mitrovicë.

Neni 2 Ndryshim plotësimi

Bazuar në nenin 7 të Marrëveshjes 02Nr. 853/22, datë 08.07.2022, për Dhënien në Shfrytëzim të Aseteve Komunale, Komuna e Vushtrrisë dhe KRM "Uniteti" pajtohen si vijon: "Njëri nga Asetet komunale të përcaktuara në nenin 2 paragrafët 2.1 dhe 2.2 të marrëveshjes bazë përkatësisht Kamioni për transportim të mbeturinave me dy (2) dyer, i kapacitetit 8 m³ Mercedes – Benz ATEGO me targë 02-622-FJ që i është dhënë në shfrytëzim KRM "Uniteti" Sh.a Mitrovicë, i kthehet Komunës së Vushtrrisë për tu regjistruar në emër të saj, te organi kompetent për regjistrim të automjeteve, në përputhje me kornizën ligjore përkatëse.

Neni 4
Numri i ekzemplarëve

Aneks Marrëveshja është hartuar në dy ekzemplar identik, nga një për palët nënshkruese.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Kjo Aneks marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese

Më, 08.02. 2023

Për Komunën e Vushtrrisë,

Frit Idrizi
Kryetar i Komunës



Për KRM "Uniteti" Sh.a

Gazmend Morina
Kryeshef Ekzekutiv

